



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë shqipe: Teknika të redaktimit dhe shprehjes

Ngarkesa: 30 kredite, 30 orë seminare
Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: *Master*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda Teknika të redaktimit dhe të shprehjes synon njohjen nga ana praktike të procesit të redaktimit. Kjo lëndë synon të njohë studentët me procesin e redaktimit, t'i ndihmojë të kryejnë pa ndikuar a dëmtuar, ndryshime objektive thelbësore, strukturore dhe stilistike, në mënyrë që punimi të paraqitet konform normave të gjuhës shqipe.

Do t'i kushtohet vëmendje anës :

a) kuptimore (semantikës):

1. Keqinterpretimi, pakuptueshmëria, kundërkuptimet, harresat e fjalive
2. Përkthim i gabuar i një fjale; shtesa/heqje që dëmtojnë kuptimin; mungesë përpikërie lidhur me terma a ngjyime fjalësh.

b) gjuhësore (sintaksës):

1. Strukturë e gabuar ose e huazuar nga teksti bazë që nuk i përgjigjet shqipes.
2. Gabime gramatikore, kuptime të dyfishta (kur nuk i ka origjinali); përsëritje e huazime të panevojshme.

c) stilistikore:

Ruajtja e stilit të autorit e të përkthyesit.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet:

- të përsosë njohuritë në gramatikën e gjuhës shqipe
- të pasurojë dhe njohë leksikun e gjuhës shqipe
- të përftojnë kompetencat e të kuptuarit, të argumentuarit dhe formuluarit për ndryshimet themelore që i duhen bërë një teksti para botimit